

Hysen IBRA

KISHA E DEÇANIT, MEGJITHATË, ËSHTË SHQIPTARE

(Reagim ndaj shkrimit të Engjëll Sedajt me titull *Me Kishën e Deçanit, Kosova më afër Evropës*, të botuar në gazetën “Koha Ditore” të dt. 28 gusht 2004)

Ky shkrim mohon realitetin historiko-arkeologjik e shpirtëror kombëtar dhe vlerat e tij, si dhe përkrah uzurpimet, përvetësimet dhe aspiratat antishqiptare serbo-ortodokse. Skkrimi është reagim ndaj shkrimit tim të botuar në gazetën “Epoka e Re” të dt. 12 korrik 2004, faqe 3 e 13, dhe në gazetën “Pavarësia” në tri vazhdimë nga 15-17 korriku i vitit 2004, me titull *UNESCO dhe Manastiri i Deçanit* edhe pse unë nuk apostrofohem.

Prof. dr. sc. Engjëll Sedaj që në titull dhe në fillim të shkrimit të vet tregon servilitetin dhe nostalgjinë për serbët dhe proserbët dhe heq dorë nga tradita dhe territori autokton amëtar me pasuritë dhe vlerat e tij, kur thotë: “Vendimi i Komitetit të UNESCO-s për ta shpallur Manastirin e Deçanit monument të trashëgimisë botërore është ngjarje e madhe në Kosovë dhe ka rëndësi të veçantë për jetën kulturore të vendit”. Profesori nuk i bën fare përshtypje fakti se nuk është respektuar procedura e vënies së Manastirit të Deçanit nën mbrojtje. Me rastin e vënies së trashëgimisë monumentale (të krijuar nga njeriu ndër shekuj apo të vlerave natyrore) nën mbrojtje doemos duhet respektuar kriteret: Definimi i objektit, destinimi i tij, lokaliteti (ngastra kadastrale, vendi ku gjendet vendbanimi, komuna, rajoni dhe shteti), arsyeja, historiku, projektuesi dhe kryesi i punëve, ndërtuesi e rindërtuesi dhe meremetuesi), koha e ndërtimit, e rindërtimit dhe e meremetimit apo e zbulimit, rikultivimit, revitalizimit dhe e vënies nën mbrojtje dhe kush kujdeset për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin. Rëndësi të veçantë ka fakti që trashëgimia monumentale të definohet se cilit¹ popull dhe besim i takon, koha ekzistimit etj. Në rastin konkret nga UNESCO është

¹ Gazeta “Koha Ditore” e dt. 28 gusht 2004, fq. 26.

legalizuar përvetësimi i Kishës (Manastirit) shqiptare të Deçanit nga Serbia okupatore dhe viti i ndërtimit (e jo i rindërtimit) nuk është definuar. Pastaj, zotëri profesor, ju për të treguar se keni të kryer fakultetin e teologjisë në Itali dhe i njihni ritet e besimeve fetare, në rastin konkret ato sllavo-ortodokse, dhe se jeni me “mish e me shpirt” për ta, për (serbo-sllavët), thoni: “Në opinionin kosovar është mirëpritur edhe lajmi se arkimadriti i Manastirit të Deçanit igumeni Teodos Shibaniq është shuguruar (më 20.06.2004) Peshkop i Lypjanit e jo i “Lipjanit” me kompetenca të vikarit të përgjithshëm të Peshkopatës të Rashkës dhe Prizrenit”. Zotëri profesor, ky citat fare nuk ka të bëjë me temën që ju e shtjelloni, arsyen e vënies së Kishës (manastirit) të Deçanit nën mbrojtje, si kishë serbe, të cilën më parë pushteti okupues serb e ka përvetësuar me dhunë nga shqiptarët. Profesor, as opinionin kosovar nuk është deklaruar publikisht se “ e ka mirëpritur edhe lejimin e shugurimit të igumenit Teodosije në Kishën e Deçanit më 20.06.2004”. Nëse e dëshmoni se ku e keni lexuar apo dëgjuar, ju kërkohet falje!

E pavërtetë tjetër e juaja, zotëri profesor, është kur thoni: “Edhe gjatë luftës së fundit (1999) aty kanë gjetur strehim dhe pritje të ngrohtë më tepër se 200 shqiptarë (dhe serbë) të rrezikuar nga agresorët (e luftës), kështu që prej themelimit të tij në shek. XIV deri më sot Manastiri i Deçanit ka pasur një histori të shënauar”. Për ta mohuar këtë gënjeshtëri dhe propagandë të ndytë tuajën, zotëri igumen, ju përkujtoj se në Kuvendin e dytë kishtaropopullor serb të mbajtur më 24-25 mars 1998, pra në fillim të luftës agresore e terroriste serbe në Kosovë, u dëshmuua se aktiviteti albanofobik dhe antidemokratik i klerikëve serbo-ortodoksë printe para politikës nacionalshoviniste e ekspansioniste të pushtetit të Beogradit e të partive dhe asociacioneve të tjera çetniko serbo-ortodokse. Pastaj kryeklerikët serbo-ortodoksë ishin në ballë të demonstratave të mitingashëve serbo-malazezë dhe bashkëkriminelë e terroristë në luftën e egër të Serbisë kundër Kosovës dhe ish-njësitë të tjera të ish-RSFJ-së. Kryetari i KMLDNJ-së në Deçan, zotëri Musa Berisha, i shkruan një letër të hapur ish-komandantit të KFOR-t në Kosovë, gjeneralit Skiaker, institucioneve të tjera ndërkombëtare dhe mjeteve të informimit, në të cilën thuhet: “...ky manastir asnjëherë nuk u vu në mbrojtje të shqiptarëve dhe së paku të distancohej nga dhuna e terrori, si dhe politika gjenocidale e pushtetit hegjemonist serb... Në fakt, shumë argumente dëshmojnë se para dhe gjatë luftës Manastiri i Deçanit ishte çerdhe e forcave komanduese, paramilitarëve, madje edhe vendstrehim i disa kriminelëve. Vetë, disa nga personeli fetar i këtij Manastiri, para se të ndodhnin disa krime mbi civilët shqiptarë, nga dëshmitarët okularë është parë duke ushtruar me armë zjarri (pushkë automatike dhe pistoleta) në vendin e quajtur “Lluga e Mark Gegës”. Dhe, më pastaj në afërsi dhe rreth

këtij manastiri vetëm gjatë majit 1998 janë vrarë 6 civilë shqiptarë nga komuna e Deçanit. Këto ngjarje pastaj kanë shkaktuar urrejtje të arsyeshme ngase aktorët e këtyre krimeve kishin për vendstrehim këtë objekt të “Shenjtrisë” serbe. Sipas evidencës së KMLDNJ-së, më 5 maj 1998, pasi që janë mbytur me torturë pleqtë Halil H. Kuqi dhe Bekë S. Cacaj nga Deçani, janë gjetur të ngulfatur në ujin e Lumit të Bardhë (Bistrica e Deçanit) që rrjedh në afërsi të këtij manastiri. Dy ditë më vonë, tek Laura, përkatësisht 200 m larg këtij objekti fetar është vrarë punëtori i hidrocentralit “Kozhnjer” Vehbi Mustafa (61), i cili në atë rast kthehej nga puna. Vrasjet kanë vazhduar edhe më tej. Të nesërmen është vrarë edhe Haki D. Kamberaj (36) nga fshati Lëbushë, ndërkaq më 21 maj 1998, në afërsi të shtëpisë së tyre vriten edhe pleqtë nga Isniqi Bajram O. Osdautaj dhe Rexhë S. Pajazitaj. Këto janë vetëm disa nga krimet që dëshmojnë për “rolin fetar” dhe “human” të këtij manastiri dhe “shënjëtrisë” së këtushme”.²

Zotëri profesor, kërkoj falje që pasioni yt, nën vallon e humanistit, internacionalistit dhe intelektualit të devotshëm, i mohon dhe i maskon krimet, urrejtjen patologjike dhe padrejtësitë që i bëhen popullit të cilit i përket-shqiptarëve nga armiku (Serbia) dhe institucionet e tij në vazhdimësi. Bile ti, zotëri igumen, i merr edhe në mbrojtje kryesit e veprave penale antishqiptare dhe antinjerëzore.

Zotëri profesor, serbo-ortodoksët me institucionet e tyre shtetërore dhe fetare në vazhdimësi kanë bërë dhe ende po bëjnë krime e dhunë të paparë ndaj shqiptarëve, traditës, kulturës, pasurisë, vlerave dhe çdo gjëje tjetër me vlerë kombëtare shqiptare. Dr. Don Gaspër Gjini shkruan: “Uroshi II filloi haptas t’i ndjekë katolikët nga vendi i tyre. Edhe më keq, në Rashkë e ndaloi ritin latin, por jo edhe në Zetë (ish-Dioklen iliro-shqiptare, përkatësisht në Malin e Zi të sotëm- H.I.), mirëpo të gjithë katolikët në këtë vend i dogji deri nën thua”,³ (në shqip). Më pas ky shkencëtar dhe fetar i nderuar shkruan: “Stefan Dushani (1331-1355), biri i Uroshit III të Deçanit... Më së pari e shpalli patrikanën e pavarur serbe, duke e emëruar si patrik kancelarin e tij të dikurshëm Joanikun...në Rashkë dhe në perandorinë greke, katolikët i urrejnë shumë... edhe latinët edhe shqiptarët gjenden në pozitë jashtëzakonisht të vështirë, sepse populli është në pranga, priftërinjtë të fyer, të shkelur dhe të poshtëruar, ipeshkvijtë dhe abatët shpeshherë burgosen... kishat, si ato katedrale, ashtu edhe të tjerat jo sllave rrënohen dhe u merrin të gjitha të drejtat, zhduken dhe shkatërrohen kuvendet”.⁴ Ndërkaq, prof. dr.

² (Curr Mazrekaj, Manastiri me disa veprime politike zë frymën e mbi 60 mijë qytetarëve të Deçanit me rrethinë (1), gazeta “Zëri” e dt. 7 maj 2002 fq. 12).

³ Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj, Zagreb 1994 fq. 94.

⁴ Po aty, fq. 95.

Skënder Rizaj, që u referohet edhe dëshmime adekuate të kohës, si J. Svire dhe M. V. Smilaniq, "Etnografsko grupisanje naroda Balkanskog poluostrva CNC, knj. XXIV, Beograd 1905 fq. 119, ndër të tjera thotë: "Nga fundi i shekullit XII shteti serb i Nemanjiqëve e nënshtroi Kosovën, e cila ishte e populluar kryesisht me shqiptarë. Kështu, Kosova u okupua nga Serbia, me ç'rast një pjesë e konsiderueshme e saj u vranë...

Zotëri, sipas kanunit (kodit të Car Dushanit të vitit 1349 (neni 2, 3,6,7,8,9, 10 dhe 21), "duhet të merren masa të repta kundër katolicizmit (heretizmit latin) dhe heretikëve të vendit".⁵ Ndërkaq, për krimet, mohimet, asimilimet, përvetësimet, kolonizimet dhe uzurpimet serbe nëpërmjet institucioneve të tyre në shek XIX dhe XX kundër popullit, hapësirës dhe trashëgimisë shqiptare, publicisti i njohur Shaban Braha shkruan: "Manastiret e Sopoçanit, Graçanicës, Pejës, Sokolicës, Deçanit etj. dhe institucioni i "Bogoslovisë" së Prizrenit ishin kthyer në vatra të panserbizmit dhe të veprimtarisë agjenturore e diversive të maskuar nën etiketë fetare dhe xhybet e prifterinjve, duke spekuluar me traditën e paprekshmërisë së faltoreve nga populli shqiptar. Guaska e ortodoksizmit pro-sllav po i shërbente gjithnjë e më aktivisht përmbajtjes së vet, nacionalizmit reaksionar serb në viset shqiptare, ku në emër të "Sveti Savës" dërgoheshin agjentët e Beogradit anembanë".⁶

Përkitazi me vazhdimësinë e politikës raciste antishqiptare të Beogradit, kryetarja e Komitetit të Juristëve për të Drejtat e Njeriut të Serbisë, znj. Bilana Kovaçević-Vučo, thotë: "Në Serbi vazhdon skizofrenia legaliste milosheviqiane. Për mua më e rëndësishme është që pas një politike të aparteidit, të cilin e ka ushtruar pushteti serb ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe një qëndrimi mjaft racist të serbëve ndaj shqiptarëve në Serbi, shqiptarët të gjejnë forcë dhe ta mbrojnë pakicën serbe në Kosovë".⁷

Kisha (Manastiri) e Deçanit e kryesuar nga igumeni Teodosije Shibashiq, që ju, zotëri Engjëll Sedaj, në shkrimin tuaj të sipërhënuar e lavdëroni dhe i jepni një shpjegim të gjerë e përmbajtësor veprimtarisë së kishës serbo-ortodokse, e në veçanti Kishës së Deçanit të kryesuar nga Teodosije "më 5 nëntor 1997 e lidh një kontratë mbi "dhurimin". Me këtë kontratë Republika e Serbisë, të cilën e përfaqëson drejtori i Drejtorisë republikane serbe për pronësi, dr. Milan Jovanović, i dhuron Kishës së Deçanit, të cilën e përfaqëson igumeni Teodosije Shibaniq, 937 hektarë tokë

⁵ Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVIII, Prishtinë 1982 fq. 422.

⁶ Gjenocidi serbo madh dhe qëndresa shqiptare (1844-1999), Tiranë 1992, fq. 86.

⁷ Gazeta "Koha Ditore" e dt. 29 korrik 2003, fq. 6.

buke pronë e qytetarëve shqiptarë të tri vendbanimeve shqiptare: Deçan, Llukë e Epërme dhe Isniq.⁸

Zotëri profesor, nuk ka institucion në botë me zyrtarë normalë, aq më tepër institucion fetar, që ua uzurpon dhe përvetëson paluajshmërinë dhe bukën e gojës rreth 40 mijë qytetarëve, pos kishave dhe institucioneve serbe! Aq më tepër, nuk ka qytetar normal që këtë veprim e quan dinjitoz!

Për veprat dhe veprimet antimorale dhe të kundërligjshme të Serbisë dhe të kishës së saj, zotëri ideolog i pasionuar pro-serbosllav, përkatësisht pro-kishës serbo-ortodokse, të përkujtoj se popat serbë ishin çdo herë në ballë të aksioneve, veprimeve dhe inicues të nismave antishqiptare dhe kundër të tjerëve. “Serbët, të cilëve iu printe kryepeshkopi i Kishës ortodokse-serbe Pavle dhe patriarku-Artemie, të shoqëruar nga Oliver Ivanoviq, aktualisht nënkryetar i Parlamentit të Kosovës, shënuan në Gazimestan, afër Prishtinës, 28 qershorin, ditën e humbjes së Betejës së Kosovës”.⁹ Deklarata e historianit serb dr. sc. Nikola Samarxhiq se “Beteja e Kosovës e vitit 1989 nuk e ka atë karakter që i mvishet, sepse në atë betejë më shumë serbë kanë marrë pjesë në anën e turqve sesa në atë serbe”, e transmetuar nga agjencia beogradase e lajmeve B-92, ka nxitur reagimin e Famullisë së Rashkës-Prizrenit, duke e cilësuar raportin si tendencioz”.¹⁰ Ndërkaq, në raportin e IWPR-së thuhet: “Kisha serbe nuk dëshiron të lejojë Malin e Zi të ketë kishën e vet autoqefale”.¹¹ “Familja e Salih Rustës së Deçanit brez pas brezi e trashëgoi “kurorën” e “vajvodës” në manastirin e Deçanit. I fundit në këtë detyrë ka qenë Hysen Demukaj, i cili në vitin 1991 hoqi dorë, ngase, siç deklaroi ai vetë, “duke parë terrorin dhe gjenocidin që po ushtron regjimi serb me institucionet e tija mbi popullin tim, vendosa të heq dorë nga kjo detyrë”.¹² Kisha serbe, zotëri ideolog, është ajo që propagandon gënjeshtër kundër shqiptarëve edhe nëpër organizmat e BE-së dhe të OKB-së, në shtetet e Evropës dhe në SHBA, kinse “shqiptarët po i shkatërrojnë dhe përdhosin kishat serbo-ortodokse në Kosovë e Metohi- 76 sosh (qershor-tetor 1999)” (libër i hartuar dhe i botuar nga klerikët serbo-ortodoksë dhe kolonistët nga Kosova më 8 nëntor 1999, 50 mijë ekzemplarë).¹³ Kishat mesjetare të nominuara në këtë libër janë kisha shqiptare të uzurpuara dhe të përvetësuara prej kriminelëve serbo-ortodoksë-Serbisë okupatore, një pjesë e kishave në libër nuk ekzistojnë apo janë kapella në varreza, garazhe apo kthina nëpër vendbanime, ndërkaq një pjesë

⁸ Shih. Kontrata 04 nr. 464-2914/97.

⁹ Gazeta “Bota Sot” e dt. 30 qershor 2002.

¹⁰ Gazeta “Koha Ditore” e dt.30 qershor 1994 fq.6.

¹¹ Gazeta “Koha Ditore” e dt. 23.01.2002 fq.9

¹² Faton Mehmeti-Fitnete Ramosaj, Deçani-Monografi, Deçan. 1997 fq.70.

¹³ Kleriket serbo.- ortadoks e kalonistëve serbë nga Kosova 8 nëntorë 1999.

e tyre janë të ndërtuara në kundërshtim me dispozitat juridiko-urbanistike, sidomos gjatë periudhës së okupimit të Kosovës nga Serbia, 23 mars 1989 - 10 qershor 1999, siç është kisha e “Shën Spasit” në kompleksin e Universitetit të Prishtinës. Këto kisha janë ndërtuar për qëllime sllavizimi të Kosovës. Zotëri ideolog, si prof.dr.sc. i shkencave filologjike dhe si prift (katolik) shqiptar, të ka takuar që së paku të reagosh me një shkrim publicistik ndaj këtyre e shumë akteve të tjera kriminale të kishës serbe e jo t’i vardisesh asaj me një servilizëm të ulët, siç bëre me shkrimin e botuar në gazetën “Koha Ditore” të dt. 28 gusht (2004)-ditën e Vidovdanit serb!

Serbët nuk kanë themeluar (ndërtuar) kisha të reja, por i kanë rindërtuar, rikonstruktuar dhe meremetuar kishat e vjetra iliro-shqiptare dhe pastaj i kanë uzurpuar e përvetësuar, duke vënë-emëruar popa, regjim, afreska dhe ikona e simbole serbo-ortodokse në kishat shqiptare, që e dëshmon edhe ky citat: “Pas rënies së Konstandinopojës më 1204, shumica e piktorëve më të spikatur të afreskave u detyruan të iknin nga Konstandinopoja dhe të kërkonin punë gjetiu; piktorët e tillë gjetën në territorin serb mjaft punë dhe krijuan vepra bizantine të cilësisë më të lartë. Kishat më të hershme u themeluan në territorin më të ngushtë të Rashkës, në veri të Kosovës”.¹⁴

Kulmi i servilizmit tuaj ndaj Serbisë dhe kishës serbo-ortodokse, është kur thoni: “Siç dihet, Manastirin e Deçanit e ka themeluar mbreti serb Stefan Deçanasi (1285-1331), kurse kisha monumentale e këtij manastiri është ndërtuar në intervalin tetë-vjeçar (1327-1335), që do të thotë se ndërtimin e ka përfunduar Dushan Stefani, i biri i Stefan Deçanasit, duke ia siguruar ngritjes së Jezu Krishtit në qiell”. Dhe, “vendimin e UNESCO-s për vënien e Manastirit të Deçanit nën mbrojtje ndërkombëtare si manastir serb” e ngreni në madhështi hyjnore pa kurrfarë baze!!! Pos aspiratave të shfrenuara serbe për të aneksuar Kosovën, siç kanë vepruar me Sanxhakun e Nishit dhe me viset e tjera shqiptare tashmë të sllavizuara, duke filluar që nga Kongresi i Berlinit (1878) e këtej dhe ndjenjave të errëta fundamentale dhe fanatike të të tjerëve për pansllavizëm dhe aneksim e sllavizim të Kosovës, asgjë të vërtetë dhe reale nuk ka! Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat në vijim: “Ndryshimet politike që ndodhën në trevat shqiptare dhe në gjithë rajonin në shek. VI-X u shoqëruan me ndryshime të rëndësishme edhe në kuadrin e organizimit kishtar. Në përfundim të dyndjeve të popujve, një sërë qendrash peshkopate u rrënuan dhe nuk përmenden më”.¹⁵ Nderkaq, në një shënim të arkivave të Vatikanit, thuhet se Car Dushani skizmatik kur filloi rindërtimin,

¹⁴ Prof.dr.sc. Noel Malcolm, Kosova, një histori e shkurtër, Prishtinë-Tiranë 2001, fq. 46-47.

¹⁵ Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i Historisë, Historia e Popullit Shqiptar I, Tiranë 2002, fq. 203.

pra jo ndërtimin, e kishës së Deçanit, u detyrua të mbronte, të siguronte, një njësi të fortë ushtarake që t'i ruante mjeshtërit, sepse vendësit (shqiptarë katolikë) nuk i lejonin mjeshtërit të punonin më tej në faltoren (kishën) e tyre”.¹⁶ Edhe burimet e tjera shkencore dëshmojnë se “mbreti Milutin Nemanjiq e ka meremetuar e rindërtuar këtë manastir në gjysmën e parë të shekullit XIV, por ndryshime të ngjashme arkitektonike janë bërë në këtë manastir gjatë disa shekujsh”.¹⁷ Ndërkaq prof.dr.sc. Edi Shukriu shkruan: “Depërtimi serb në Kosovë e në jug, siç pohon edhe K. Jeriçek, nisi (filloi) tek nga fundi i shek. XI”.¹⁸ Nga dëshmitë e kohës, “Kisha serbe nis me përvetësimin e objekteve të rëndësishme sakrale, që u ngritën dhe me shekuj ishin në shërbim të popullatës autoktone arbërore”.¹⁹ Studiuesi prof.dr.sc. Jahja Drançolli në sesionin shkencor të mbajtur më 13-15 shtator 2004, me rastin e 50-vjetorit të themelimit të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, në kumtesën me titull *Monumentet e kultit katolik në Kosovë*, thotë: “Periudhën e Mesjetës serbët e kanë quajtur dhe e quajnë si periudhë e artë e Serbisë. Të dhënat arkeologjike, burimet e shkruara dhe arkivat e shumtë nëpër Ballkan dhe Evropë dëshmojnë për një numër të madh të kishave katolike arbërore dhe të personelit arbëror që kanë qenë në pjesë të ndryshme të Kosovës në periudhën e Mesjetës. Janë pikërisht kishat dhe manastiret katolike iliro-arbërore, të cilat serbët i kanë shndërruar në kisha dhe manastire ortodokse dhe atë pikërisht mbi themelet e atyre të mëparshmeve. Ai e përmend rastin e manastirit të Deçanit që në Mesjetë, por edhe më herët, ka qenë kishë katolike e punuar nga një arkitekt arbëror me një arkitekturë të një kisha katolike të Firencës së Italisë. Përveç kësaj, edhe manastiri ortodoks i Pejës, Kisha e Shën Premtes në Prizeren janë të ndërtuara dhe të përvetësuara mbi themelet e kishave iliro-shqiptare”.²⁰ Këtë e dëshmojnë materiali ndërtimor dhe lokacioni, në veçanti fotografitë e kishave në Kosovë më heret dhe sot. Edhe prof. dr. sc Qemal Murati shkruan se “Shqiptarët i kanë pasur kishat e veta qysh para ardehejs së sllavëve në Kosovë, për çka dëshmon edhe terminologjia e formuar kishtare e burimit kryesisht latin të shqipes, në të cilën-mungon kryekreje elementi ortodoks, që është kjo një rrethanë me rëndësi, siç thotë Eqrem Çabej, si për

¹⁶ Prof. dr.sc. Skender Rizaj, “Shqiptarët dhe serbët në Kosovë, Prishtinë 1991, fq. 78.

¹⁷ Dr. Konstandin Jeriçek. Istorija serba, knj. I, Beograd 1952, f. 264 dhe akad. Mark Krasniqi, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Gjurmë e gjurmime, Prishtinë 1979, fq. 155.

¹⁸ Kosova - kontinuiteti etnik dhe historik i subjektivitetit të saj, Instituti i Historisë, revista shkencore “Kosova”, Prishtinë, nr. 8/2000, fq. 45, dhe 2. K. Jeriçek e J. Rado-niqi, Istorija serba I, Beograd, fq. 124.

¹⁹ Edi Shukriu, po aty fq. 47.

²⁰ Gazeta “Zëri”, dt. 14 shtator 2004, fq. 15.

gjuhësinë dhe historinë shqiptare”. Kishat shqiptare i përkasin antikës së hershme”.²¹

Veprimtarët dhe ushtarakët e UÇK-së nga komuna e Deçanit Faton Mehmetaj e Fitnete Ramosaj shkruajnë: “Komuna e Deçanit është dhe ka qenë një komunë me popullsi tipike shqiptare, ku 95% janë shqiptarë e 5 % serbë, malazezë e romë. Serbët e malazezët që përbëjnë një përqindje fare të vogël, rreth 2%, janë kolonizatorë të ardhur këtu gjatë periudhave të ndryshme (që nga Kongresi i Berlinit (1878-H.I.), sidomos gjatë sundimit të Jugosllavisë së vjetër dhe pas Luftës së Dytë Botërore”.²²

Profesor, besoj se edhe pas këtyre argumenteve dhe të tjerave, ende nuk mund të bindeni se kishat mesjetare në Kosovë dhe në vise të tjera shqiptare nën Serbi, Mal të Zi, Maqedoni dhe nën Greqi, janë iliro-shqiptare, të uzupuara, të përvetësuara, të rindërtuara, të rikonstruktura, të meremetuara për qëllime nacional-shoviniste dhe ekspansioniste të këtyre shteteve. Nuk mund të bindeni ngase nuk mund të hiqni dorë nga nostalgjia e zjarrtë që keni për serbo-sllavo-helena-ortodoksizmin ti dhe UNESCO-ja.

Serbia me institucionet e saja, veçmas me anë të kishës serbo-ortodokse, nuk ka rrënuar, uzurpuar dhe përvetësuar vetëm kisha e manastire shqiptare, por edhe hapësirë, kështjella, simbole, armë, stoli, enë, dokumentacion dhe pasuri tjetër të paluajtshme dhe të luajtshme. Ajo i ka okupuar dhe përvetësuar Kosovës dy treva sa Kosova (Toplicën dhe Kosanicën) me një sipërfaqe prej 22.023 km katrore, të cilat i ka sllavizuar. Serbia në kohë të vonshme aspiratat e veta ekspansioniste dhe nacional-shoviniste antishqiptare i ka shprehur haptas në mënyrë të organizuar dhe institucionale që me elaboratin shfarosës të Ilija Garashaninit të vitit 1844; “Knjaz Mihali i porositur nga Franjo Zahu dhe Ilija Garashanini nxori “Ligjin për vendosjen e banorëve të huaj”. Me të planifikohej spastrimi etnik dhe kolonizimi i trojeve shqiptare në Sanxhakun e Nishit dhe të Pirotit. Ky plan u realizua në dimrin e viteve 1877-78 dhe pas Kongresit të Berlinit kur Serbisë iu njoh zgjerimi territorial në trojet e okupuara shqiptare. Popullsia e 715 vendbanimeve u dëbua për tri ditë nga vatrën e veta”.²³ Për grumbullimin, plaçkitjen, përvetësimin, dëmtimin dhe mohimin e shumë veprave artistike, varreve, tumave, stelave, epitafëve, freskave, enëve dhe shumë veprave arkeologjike që janë të grabitura prej serbëve flet edhe Balduin Sara në një punim të botuar në vitin 1926 në revistën e Institutit të Arkeologjisë të Vjenës. Aty ai përmend një altar me mbishkrim të kopjuar që prej Krikut të

²¹ Gazeta “Dielli” e dt. 10 prill 1991, fq.7.

²² Deçani-Monografi, Deçan 1997, fq. 7.

²³ Dr.sc. Hakif Bajrami, Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës (1844-1995), Prishtinë 1995, fq. 26.

Ankonës në vitin 1418, një mbishkrim të perandorit Ardian, një relief të Panit me tri mimfat, stelën e Aristodamit, edhe nga Durrësi dhe kokën prej mermeri të djaloshit, të ekspozuar edhe prej arkeologut tjetër Prashniker.²⁴ Ndërkaq, gjatë viteve 1998-1999, sipas drejtorit të Muzeut të Kosovës, Arbër Hadri, rreth 1000 eksponate me vlerë arkeologjike janë marrë nga Kosova dhe janë dërguar në Beograd”.²⁵

Zotëri profesor, nga këto dëshmi, në mesin e shumë e shumë të tjerave, shihet se serbo-sllavo-helenët që moti në vazhdimësi dhe në çdo sferë kanë bërë përpjekje mbinjerëzore që të mohojnë dhe të zhdukin çdo gjë me vlerë shqiptare. Medet për atë që nuk dëshiron të dijë dhe nuk i kundërvihet të keqes, të dëmshmes dhe aspiratave gllabëruese, veçmas kundër popullit të tij! Për atë që mohon vetveten nuk ka mjerim më të madh!!! Vërtet është e pabesueshme që ti, zotëri Engjëll Sedaj, dhe kolegu i yt Halit Tërnavci, si doktorë të shkencave filologjike shqipe, viheni në shërbim të plotë të armiqve ordinerë terroristë të popullit shqiptar, të serbo-sllavo-helenëve ortodoksë. Si duket, jeni duke garuar se cili po shërbeni më shumë në dëm të atdheut, e kështu t'ia kaloni Esad pashë Toptanit dhe Markagjonit. Hil Mosi i madh, kur e shkroi vjershën “Tradhëtori” kishte parasysh personalitetet antikombëtare që sot janë aktuale në mesin e shqiptarëve, të cilët e mohojnë popullin dhe hapësirën kombëtare me pasuritë, vlerat dhe trashëgiminë e saj, që e humbin pavarësinë dhe sovranitetin e shtetit, që marrin pozita në emër të çështjes kombëtare e veprojnë kundër interesit kombëtar dhe shtetëror, nuk bëjnë përpjekje për ribashkimin kombëtar-territorial, mohojnë apo zhvleftësojnë pasuritë, vlerat dhe trashëgiminë, traditën, gjuhën, simbolet dhe gjërat e tjera me vlerë të kombit, vrasin, spiunojnë, varfërojnë, eksploatojnë popullin e vet, shkatërrojnë, uzurpojnë dhe përvetësojnë pasurinë kombëtare e shtetërore, deurbanizojnë vendbanimet dhe shkatërrojnë, degradojnë dhe ndotin ambientin jetësor (tokën bujqësore, tokën ndërtimore, pyjet, ujin, ajrin), shkaktojnë zhumë, pasiguri, destabilitet dhe joqetësi në vend etj. etj. Shqiptarët në të kaluarën nuk kanë qenë dhe nuk janë as sot si shumicë e këtyre kategorive. “Shqiptarët kanë shkëlqyer edhe në gjëra të tjera, përveç posteve ushtarake. Dijetarë seriozë pretendojnë që kanë pasur etni shqiptare edhe Homeri, Aristoteli dhe Hipokrati, “Babai i Mjekësisë”. Xheroni, që përktheu biblën në latinisht (Vulgotën) ishte pasardhës ilir, apo shqiptar, siç ishte edhe Papa Klimenti XI. I tillë ishte edhe Patriarku Ekumenik Athenogoras, i cili më 1964 u takua me Papa Palin VI për të çliruar njëri-tjetrin nga anatemat e 1054-ës, që ndanë Kishën Katolike Lindore nga Perëndimi... Mungesa e dokumenteve të hershme

²⁴ Gazeta “Koha Ditore” e dt 19 qershor 2004, fq. 36.

²⁵ Gazeta “Koha Ditore” e dt. 19.08. 2001.

shqipe na ka lënë vetëm gjurmë të mangëta të fillimeve të tyre... Shqipëria e sotme e zvogëluar është bërë sanduiç midis ish-Jugosllavisë dhe Greqisë”.²⁶

UNESCO-ja si organizatë profesionale (e specializuar) e OKB-së për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, e cila në gjiun e vet përfshin mbrojtjen, rikultivimin dhe rivitalizimin e trashëgimisë monumentale të krijuar nga njeriu ndër shekuj dhe të natyrës, e themeluar në Konferencën e Londrës më 1945, kurse ka filluar të veprojë më 1946, doemos duhet ta anulojë vendimin e vet për vënien nën mbrojtje të manastirit të Deçanit si kishë serbe, por si kishë shqiptare, vendim ky i marrë më 02.07.2004 në Pekin padrejtësisht!!!. Kisha (manastiri) e Deçanit vetëm si e tillë do të jetë dinjitoze dhe do ta luajë rolin e vet si trashëgimi me vlera të shumta e të larta monumentale, në mesin e 754 të tjerave që janë në mbrojtje të UNESCO-s.

²⁶ Edwin Jacques, Shqipëtarët-historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, në shqip, Tiranë 1995, fq. XIII e XIV.